



I vaksinuar - i mbrojtur: në kopshtin për fëmijë dhe qendrën e kujdesit ditor për fëmijë (Dado)



Të dashur prindër!

Tashmë fëmija juaj shkon për herë të parë në një kopsht për fëmijë ose në një qendër të kujdesit ditor për fëmijë. Jepini fëmijës tuaj mbrojtjen e nevojshme duke e vaksinuar sa më mirë kundër shumë sëmundjeve infektive.

I vaksinuar – i mbrojtur: Siguri për fëmijën tuaj dhe për të tjerët

Vaksina mbron fëmijën tuaj. Përveç kësaj, ju merrni përsipër edhe një përgjegjësi sociale: Fëmijët e vaksinuar zakonisht nuk i infektjnë të tjerët dhe kështu mbrojnë të gjithë ata që janë ende shumë të vegjël për vaksinim ose që nuk mund të vaksinohen për shkak të mungesës së imunitetit. Kjo mbron edhe nënat shtatzëna të pavaksinuara dhe fëmijët e tyre të palindur.

Sidomos fëmijët në moshë foshnjore dhe të mitur janë të rrezikuar ndaj shumë sëmundjeve infektive tepër ngjitëse. **Prandaj, para se fëmija juaj të fillojë të ndjekë një formë të kujdesit ditor, duhet të kontrolloni statusin aktual të vaksinimit të fëmijës tuaj dhe nëse është e nevojshme të bëni vaksinimet (shitese)!**

Vaksina kundër fruthit– pse është aq e rëndësishme?

Fruthi nuk është i parrezikshëm. Ai dobësojn mbrojtjen natyrore të trupit për disa muaj dhe mund të kenë pasoja të rënda dhe në raste të rralla edhe fatale. Për më tepër është shumë ngjitës. Prandaj, fëmijët nga mosha 12 muajsh mund të shkojnë në kopsht ose qendrën e kujdesit ditor vetëm nëse janë vaksinuar në mënyrë të duhur kundër fruthit. Kjo parashikohet në Ligjin për Mbrojtjen nga Fruthi. Nga kjo përjashtohen fëmijët me një dëshmi mjekësore që deklaron se kanë imunitet ndaj fruthit ose se nuk mund të vaksinohen për shkak të një kundërrindikacioni mjekësor.

Në dy vitet e para të jetës rekomandohen shumë vakcina të rëndësishme.

Të gjitha vaksinat e rëndësishme të rekomanduara nga Komiteti i Përhershëm i Vaksinimit mund t'i gjeni në [link2.bayern/rki-impfkalender](https://www.bayern.de/rki-impfkalender).

Ndër të tjera rekomandohen vaksinat kundër tetanozit, difterisë, poliomyelitit, kollës së mirë, Haemophilus influenzae tip b dhe hepatitit B. Në shumicën e rasteve, ato ofrohen si vaksinë me pesë përbërës (duke përjashtuar hepatitin B) ose gjashtë përbërës. Kështu mund ta mbron fëmijën tuaj nga sëmundje të shumta infektive të rrezikshme me vetëm një injeksion. Nëse e keni vaksinuar fëmijën tuaj me vaksinën pesë në një, ju lutemi mos harroni të bëni vaksinimin e munguar ndaj hepatitit B! Hepatiti është një sëmundje serioze që mund të çojë në dëmtime të rënda të mëlçisë.

Vaksinim i humbur? Nuk ka problem.

Vaksinat e humbura mund të rikuperohen në çdo kohë. Shfrytëzoni mundësinë dhe rifreskoni mbrojtjen me vaksinë për fëmijën tuaj, por edhe për të gjithë familjen.

Efikasiteti dhe siguria e të gjitha vaksinimeve të rekomanduara monitorohen vazhdimisht dhe rreptësisht nga autoritetet qeveritare. Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me vaksinimet, mjekët në qytetin e Bayern-it dhe autoriteti juaj shëndetësor lokal janë të gatshëm t'ju këshillojnë. Informacione të mëtejshme mbi vaksinimin mund të gjenden në www.impfen.bayern.de.

